



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PARAJA ELEKTRONIKE



E-BANKING

Departamenti i Sistemeve të Pagesave



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



Përmbajtja

Paraja dikur dhe sot.....	4
Paraja elektronike	7
Përparësitë e parisë elektronike.....	13
Mangësitë e parisë elektronike.....	14
Përdorimi i parisë elektronike në Kosovë.....	15

Paraja dikur dhe sot

Paraja tregon vlerën e secilit mall. Ajo paraqet njësinë e përlllogaritjes dhe të ruajtës së vlerës. Gjatë historisë paraja ka ndërruar formën fizike të saj, nga gjësendet apo mallrate caktuara të cilat përdreshin si mjet këmbimi; metalet e çmuara, monedhat, kartëmonedhat, deri te çeqet, llogaritë bankare, kartelat bankare etj.

Amundtë paramendohet bota pa para ashtu si nën jehonë sot?



Me zhvillimin e teknologjisë u mundësua dhe u zhvillua një aspekt i ri në perceptimin dhe përdorimin e parasë. Përkundër faktit se paraja e gatshme akoma qëndron si mjet pagese më i përhapur, mënyra tradicionale e përdorimit të parasë ka pësuar ndryshime. Pagesat sot bëhen duke përdorur para të gatshme, kartela apo transferet bankare. Këto mënyra janë instrumente të pagesave. Dallojmë dy grupe kryesore të instrumenteve të pagesave; në letër dhe elektronike.

Instrumentet letër janë: paraja e gatshme, çeku, urdhërtransferet dhe urdhërpagesat në letër.



<u>A/C Payee Only</u>	<u>Payable at Par</u>
Date <u>14-07-1999</u>	
Pay <u>Avantage Solutions Ltd.</u>	
Rupees <u>One Lakh Twenty Thousand Four Hundred</u>	
<u>Seventy Five Only</u>	
Rs. <u>**1,20,475.00</u>	
Citibank, N.A. Chennai Payable at Par at all Citibank branches in India	
A/c No. <input type="text"/>	
GCB/SA	#FSC - CMI0000003
	Director

Instrument elektronik

Është paraja elektronike, shembull i formës së përdorimit të kësaj paraje janë: kartelat bankare, pagesat përmes internetit, paraja elektronike, e-banking, pagesat përmes telefonit, urdhërpagesat elektronike, paraja virtuale, etj.

Këto dy forma të parasë shndërrohen në njëra tjetrën. Njeriu sipas nevojës tërheq para nga llogaria e tij dhe i merr ato si para të gatshme, gjithashtu kur ka në posedim para të gatshme duke i deponuar ato në llogarinë e tij ai i përdor ato pastaj si para elektronike.

Paraja Elektronike

Paraja elektronike i referohet parasë dhe transaksioneve që kryhen me të dhe këto veprime kryhen duke vënë në përdorim mjetet elektronike: interneti, kompjuterët, ndërlidhjet, sportelet automatike -ATM (Automated Teller Machines), pikat e shitjes - POS (Point of Sale), etj.



Paraja elektronike mund të përdoret vetëm në mënyrë elektronike. Ajo mund të ruhet në një kartelë, në një kompjuter apo pajisje të tjera të teknologjisë informative ose në mjete të tjera. Paraja elektronike nënkupton se të gjitha veprimet kryhen në mënyrë elektronike, rezultati i të cilave është kalimi i fondeve nga llogaria bankare e blerësit te llogaria bankare e shitësit.

Përdorimi i parasë elektronike mundësohet me angazhimin dhe përfshirjen e një numri të mekanizmave të pagesave dhe akterëve.

Akterët kryesorë janë: emetuesit, klientët, tregtarët.

- Emetuesit janë banka ose institucionet tjera jo banka (rrjetet tregtare, etj.)
- Klientët janë përdoruesit e parasë elektronike;
- Tregtarët janë ata të cilët pranojnë para elektronike në shkëmbim të mallrave dhe shërbimeve që ofrojnë.

Pjesëmarrës tjetër i rëndësishëm në këtë proces janë edhe institucionet e shtetit, të cilat janë të ngarkuara dhe të autorizuara për mbikëqyrje të sistemit financiar, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit dhe sigurisë së sistemit të pagesave përfshi edhe paranë elektronike nga falsifikimi apo ndonjë veprim tjetër i dëmshëm dhe kundërligjor.

Hapja dhe posedimi i një llogarie bankare është hapi i parë dhe kryesor në procesin e pagesave në përgjithësi dhe në veçanti të atyre elektronike. Edhe klientët edhe tregtarët duhet të kenë llogari bankare në mënyrë që të kryejnë pagesa përmes bankës apo përmes instrumenteve të tjera jo kashtë pagesave

Me hapjen e llogarisë, klienti pranon një kartelë bankare. Vlera elektronike e parasë të cilat klienti i ka në llogari, ruhen në kartelën elektronike bankare, e cila është në pronësi të klientit. Kjo vlerë reduktohet sa herë që klienti e përdor kartën elektronike për të kryer pagesat ëndryshme.

Klienti për mallra dhe shërbime të cilat i blen, merr fatura në të cilat figuron vlera e mallrave dhe shërbimeve të shprehura në para elektronike. Ky informacion mbi blerjen ruhet në rrjetin e përgatitur nga emetuesi i parasë elektronike. Përmes këtij rrjeti emetuesi i parasë elektronike konfirmon kryerjen e transaksionit, duke bërë bartjen e shumës së parasë elektronike të përdorur. Igjithë ky proces kryhet në mënyrë elektronike.

Pra, paraja elektronike është e “padukshme” në sytë e njeriut.

Mekanizmat të cilët mundësojnë përdorimin dhe qarkullimin e parasë elektronike janë:

- Transferet e kreditit
- Kartelat bankare
 - Debit kartela
 - Kredit kartela
 - Kartela me parapagim (rimbushëse)
- E-banking
- Mobile banking
- Urdhërpagesa periodike,
- Debitim Direkt
- Pagesa Giro

- **Transferet e Kreditit** - Udhëzim nga paguesi, bankës së tij që të debitojë llogarinë bankare të tij, dhe t'ia kreditojë llogarinë bankare përfituesit të fondeve.

- **Kartelat Bankare** - Kartela që lëshohen nga bankat komerciale (emetuesi) dhe mundësojnë klientit të paguajë me fondet nga llogaria bankare e tij.

Llojet e kartelave më të përhapura në Kosovë janë VISA dhe MasterCard.

Debit Kartela - I mundëson klientit që të kryejë pagesa dhe të tërheqë paratë gatshme nga llogaria bankare e tij, deri në vlerën e fondeve të cilat i kanë llogari.

Kredit Kartela - I mundëson klientit të kryejë pagesa edhe pse nuk ka mjete në llogari, duke shfrytëzuar kreditin e lejuar nga banka në bazë të marrëveshjes paraprake. Për mjete të shfrytëzuara klienti i paguan bankës interes.

Kartela me Parapagim - Klienti ka në dispozicion një shumë të caktuar për përdorim.




- *E-Banking* - Mundëson klientit qasjen në llogarinë e tij dhe kryerjen e pagesave përmes internet portalit të bankës.



- *Mobile Banking* - Mundëson klientit kryerjen e një numrit të transaksioneve nga llogaria e tij bankare përmes përdorimit të telefonave mobil.
- *Urdhërpagesa periodike* - Mundëson klientit të urdhërojë bankën e tij të kryejë pagesat e rregullta në intervalet e caktuara kohore në shumë të caktuar.

- *Debitimi Direkt* - I mundëson klientit që në bazë të marrëveshjes paraprake, të autorizojë bankën e tij (përmes kompanisë përfituese) që të kryejë pagesa të rregullta nga llogaria e tij në llogarinë e përfituesit.

Për DEBITORIN

 <p>Debitimi Direkt</p>	Sistemi i Pagesave Ndërbankare Debitim Direkt në SPN	Emërtimi dhe logo e kreditorit																
	<table border="1" style="width: 100%; height: 20px;"> <tr> <td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td> </tr> </table> <p>Numri unik i referencës së autorizimit (të plotësohet nga kreditori)</p>																	
Me nënshkrimin e këtij autorizimi unë: A. Autorizoj (emërtimi i kreditorit) të i dërgojë bankës time udhëzimet për debitimin e llogarisë time, dhe B. Autorizoj bankën time (emërtimi i bankës) të debitojë llogarinë time në bazë të udhëzimeve nga (emërtimi i kreditorit). Ju keni të drejtë të kërkonit kthimin e mjeteve nga banka juaj sipas kushteve të marrëveshjes me bankën tuaj. Kërkesa për kthim duhet të dorëzohet më së voni XX jave pas datës së debitimit të llogarisë tuaj. Të drejtat tuaja janë të sqaruara në deklaratën të cilën mund ta merrni në bankën tuaj.																		

- *Pagesa Kos Giro* - I mundëson klientit të kryejë pagesën e detyrimit ndaj kompanive publike përmes faturave standarde, me mundësi leximi automatik të faturës përmes lexuesve të barkodeve.

Kos-giro

Ju lutem shikojtuni këtë pjesë!
Mollmo vas pocapate ovaj deo
Please retain this stub

Shuma / Iznos / Amount

€ Euro Ct

Prej llogarisë së bankës / Od ziro racuna / From bank account

Prej / Od / From

Emri / ime / Name

Adresa / Adresa / Address

Vendi / Mesto / Place

Për / Za / To

Nënshkrimi / Potpis / Signature

A i keni plotësuar fushat e kuqë?
Dali ste popunili crvena polja?
Have you filled in all red sections?

© BPK

Ju lutem mos shkruani në hapësirën më poshtë / Ne pisli u donju površinu / Please do not write in this space below please do not fold

Referenca / Referencija / Reference Prej / Od / From Euro Ct Për / Za / To code

Përparësitë e parasë elektronike

Përmes parasë elektronike mund të kryhen të gjitha veprimet në jetën e përditshme sikurse me paranë e gatshme. Lehtësimi të cilën e ofron paraja elektronike është se nuk kemi nevojë për bartje të parasë së gatshme, që na kursen kohën për të shkuar në bankë për të tërhequr para (na kursen nga rreziku i humbjes, grabitjes, falsifikimit, mashtrimit, etj.) apo për të kryer pagesa dhe transferet të tjera. Në rast të udhëtimeve e gjitha që na duhet të kemi është kartela bankare. Personave me aftësi të kufizuara iu mundëson të kryejnë veprimet e nevojshme financiare pa pasur nevojë, që fizikisht të jenë në banka apo të ngarkojnë dikë tjetër për këtë. Përparësi tjetër është se paraja elektronike është më e sigurt, e pa dëmtueshme (nuk griset, laget, shlyhet, me kalimin e kohës, etj.). Përdorimi i parasë elektronike na ofron më tepër; lehtësi, shpejtësi, efikasitet, efektshmëri dhe qasje globale.



Mangësitë e parasë elektronike

Kostoja fillestare e aplikimit për një kategori të klientëve mund të paraqet pengesë (kompjuteri, qasja, softuerë, etj.).

Besimi në këtë lloj të operacioneve financiare, pa kontakt me personelin e bankës për klientët tradicional fillimisht mund të duket e vështirë, sikurse edhe periudha fillestare e përshtatjes dhe mësimi i përdorimit të instrumenteve të parasë elektronike.

Rreziku i ndërhyrjes së paautorizuar në llogaritë e klientit.

Institucionet të cilat ofrojnë këto shërbime përdorin mjetet, mënyrat, pajisjet dhe shërbimet më të përparuara të sigurisë në mbrojtje të klientëve të tyre, me qëllim të eliminimit dhe parandalimit të kriminalitetit elektronik. Në këtë aspekt edhe klientët duhet të jetë të kujdesshëm dhe të zbatojnë masat e sigurisë në qasje online dhe/apo përdorim të instrumenteve të pagesave jo cash (kujdes me fjalëkalimet, PIN, etj.).

Përdorimi i parasë elektronike në Kosovë

14 ATM-ë të parë në Kosovë kanë filluar punën në vitin 2002 dhe në vitin 2012 ky numër ka arritur në 483, ndërkaq numri i POS-ëve të parë të cilët janë funksionalizuar në vitin 2005 nga 1,046 ka arritur në 8,592 në vitin 2012.

Numri i kredit kartelave nga 11,139 në vitin 2008 ka arritur në 95,942 në vitin 2012, ndërsa numri i debit kartelave nga 105,713 në vitin 2008 ka arritur në 599,651 në vitin 2012.

Numri i llogarive bankare me shërbimin e-banking në vitin 2005 ishte 837 ndërsa në vitin 2010 ky numër ishte 55,292 dhe në vitin 2012 ky numër rritet në 97,089.

Gjatë gjashtë mujoritë të parë të vitit 2013 në Kosovë në përdorim ishin:

- ATM - 497
- POS - 8,550
- Kartela krediti - 102,639
- Kartela debiti - 628,173
- Llogarie e-banking - 121,806

Rritja e numrit të përdorimit të këtyre instrumenteve është në proporcion me rritjen e numrit të pagesave ndër bankare në Kosovë, fakt ky që flet për rritjen e vazhdueshme të besimit në sistemin bankar dhe përdorimin më masiv të instrumenteve të pagesave.





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Adresa: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Rruga Garibaldi nr. 33, 10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

E-mail: paymentsystems@bqk-kos.org

Web: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,59>

Tel: ++ 381 38 222 055

Fax: ++ 381 38 244 410

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në faqen zyrtare:

www.bqk-kos.org



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO